Organizer

Ministry of Transport and Telecommunication

Summary on the seventh edition of International Fair of Information and Communications Technology "ITTF 2010"

The seventh edition of International Fair of Information and Communications Technology, "ITTF 2010" which was held from 27–29 May at the Pallati i Rinisë center in Prishtina, was characterized by numerous innovations.

"ITTF 2010" brought together key stakeholders in the field of Information Technology and Telecommunications from Kosovo and beyond.

Our cooperation with the Ministry of Transport and Telecommunication under the patronage of which was held this fair, as well the cooperation with the other associations in the field of IT in enhancing the comprehensive quality of this fair continues, making this event the largest meeting point between experts, distributors and professionals in the field of IT in our country.

This year's edition marked not only increase in the number of exhibitors but also in the products and services that the sector of Information Technology and Telecommunications offers. This year's edition, regardless of number of exhibitors' increase compared to past years, was richer by variety of bids, which had more equipment, more Software, offers and choices for telecommunication, training programs, programs and solutions from "business intelligence", etc.

Another innovation of this edition was the number of accompanying activities that took place during the fair, such as conferences and varied scientific presentations. These presentations were held by experts of exhibiting companies and others, who presented to the public topics on new developments of these sectors.

As never before, exhibiting companies, visitors and the organizer of the fair have turned this activity into a media that is giving the true message that Kosovo, as a country with the youngest population in Europe, has prerequisites to become a leading country in the field of IT and Telecommunication in the region.

At the inauguration of the fair, the director of the Department of Information Technology and Telecommunication in the Ministry of Transport and Telecommunication, Mr. Agim Kukaj executive director of the Association of Information Technology and Telecommunication "STIKK", Mrs. Vjollca Çavolli, as well as the representatives from the business community,

representatives of local and international institutions in Kosovo have participated and held speeches.

Supported by:

Media partners:

Information about the ITTF 2010 Fair

- Official opening: 27 of May 2010, at 10.00
- Place: Pallati i Rinisë center, Prishtina
- Exhibitors' number: 68
- Exhibitors' Origin: Kosovo, Albania, Macedonia, Turkey, Greece, USA, UK, Austria, Switzerland.
- Total number of visitors: 26,386
- Number of professional visitors: 14,177
- Number of public visitors: 12 209
- Visitor's profile: Specialists in the field of IT and Telecommunication, employers, distributors, managers of public and private companies, institution leaders, teachers, students, etc.
- On May 29, handing out the certificates and appreciations to the exhibitors.

Fair's activity agenda

27 May

- 10:00 Official opening – speeches from heads of Kosova institutions, international institutions and business community
- 10:00-19:00- exhibition time
- 11:00-11:30, Presentation by CACCTUSS *"IBM eX5 - Redefining the X86 landscape"* lecturer Mr. Martin Maksimovski
- 11:30-12:00, Presentation by CACCTUS *"Microsoft Windows 7 and Windows SBS"* lecturers Mr. Arton Istogu & Mr. Florent Sahiti

- 12:00-12:20, Presentation by STIKK *"Sfidat e sektorit TIK në Kosovë"* lecturer, Ms. Vjollca Çavolli

- 16:00-17:00, Presentation by Macher Solutions*,"Optimize your Business Performance (Strategic Planning, Predictable Performance, Confident Decisions and Process Optimization) with Business Intelligence!"* lecturers: Mr. Dieter Macher & Ms. Qamile Mehmeti

- 20:30, ITTF PARTY organized by CEO, venue SHESHI 21.

---

28 May

- 10:00-19:00, exhibition time

- 12:00-13:00, Presentation by Faculty of Electrical & Computer Engineering (UP) *"siguria e të dhënave"*, lecturer Mr. Ehat Qerimi

- 13:00-14:00, Presentation by Faculty of Electrical & Computer Engineering (UP) *"e-University",* Lecturer Mr. Haxhi Lajqi

- 14:00-15:00, Presentation by Macher Solutions*,"Optimize your Business Performance (Strategic Planning, Predictable Performance, Confident Decisions and Process Optimization) with Business Intelligence!"* Lecturers: Mr. Dieter Macher & Ms. Qamile Mehmeti.

- 15:00-16:00, Presentation by CACCTUS *"Oracle – Business Intelligence"* lecturer Mr. Gabriel Trauvich

- 16:00-17:00, Presentation by CACCTUS *"Oracle Databases"* lecturer Mr. Gabriel Trauvich

---

29 May

- 10:00-16:00, exhibition time.

- 11:00-11:30, Presentation by CACCTUS, *"Zgjidhja për faturim të thirrjeve për IP telefonike"* lecturers: Mr. Ashkën Adili & Mr. Lirak Cana

- 11:30-12:00, presentationa bu Gekos *"Arkat fiskale"*

- 13:30, Giving out certificates for exhibitors

- 16:00, Closing the Fair and removal of Exhibitors

SPECIAL MEDIA ATTENTION

The fair was followed by the mainstream media in the country, such as:

TV's:
RTK, RTV21, KTV, FAN TV, TV Klan Kosova, Radio Kosova, Radio Dukagjini, Radio Blue Sky, Radio 21, etj.

Daily Newspapers and Magazines:
Koha Ditore, Kosova Sot, Bota Sot, Infopress, Gazeta Express, Lajm, Zëri, Epoka e Re, Prishtina Post, etj.

News agencies:
Infosot, Kosova Press, Telegrafi, Kosova Live, Agjencia Ekonomia, Kosovanews, Kosova Info, etj.

Pictures from the ITTF 2010 fair

PCWorld
Albanian
PCWorld
Technology Advice You Can Trust!
TECH UPDATE
PCWorld
IDG


TOSHIBA
MF SYSTEMS

TOSHIBA
ptk
posta
powered by PTK

IPKO

Press about the ITTF 2010 fair

Sot hapen dy panaire

PRISHTINË, 26 MAJ - Sot (e enjte) do të hapen dy panaire ndërkombëtare: Panairi i Teknologjisë Informative dhe Telekomunikacionit "ITTF" dhe Panairi i Mjekësisë dhe Farmaceutikës "MEDIKOS", që do të mbahen deri më 29 maj 2010 në Prishtinë.

Nis IT panairi

PRISHTINË, 27 MAJ — Edicioni i shtatë i panairit të teknologjisë informative, "ITTF2010", i cili u hap të enjten në Pallatin e Rinisë dhe Sporteve, ka mbledhur së bashku akterët kryesorë të fushës së teknologjisë informative dhe telekomunikacionit nga Kosova dhe më gjerë.

Sipas organizatorëve, edicioni i shtatë i këtij panairi shënon rritje jo vetëm të numrit të ekspozuesve, por edhe të produkteve dhe shërbimeve që ofron sektori në fjalë, ku do të ketë më shumë pajisje, më shumë softuerë, programe trajnuese, programe dhe zgjidhje nga 'business intelligence'.

"Ky panair është ngjarje me rëndësi për sektorin e teknologjisë informative dhe komunikuese si dhe për zhvillimin e shoqërisë informacionit", ka thënë Agim Kukaj, drejtor i Departamentit të Teknologjisë Informative në MTPT.

Ai shtoi se MTPT-ja së bashku me Autoritetin Rregullativ të Telekomunikacionit janë duke punuar për marrjen e domenit, i cili do të krijohet në fund të këtij viti.

Panairi i shtatë i teknologjisë informative është organizuar nga CEO-Congres and Event Organisation nën përkujdesjen e Ministrisë së Transportit dhe Postë-Telekomunikacionit dhe mbështetjen e STIKK-ut, dhe është i hapur deri më 29 maj.

Hapet panairi ndërkombëtar i teknologjisë informative, dhe i farmaceutikës

Është hapur panairi ndërkombëtar i teknologjisë informative dhe telekomunikacionit "ITTF" edicioni i shtatë dhe ai i mjekësisë dhe farmaceutikës "Medikos" edicioni i gjashtë, të cilët janë organizuar nga CEO. Lulëzim Krasniqi, menaxher i CEO-s, tha se në krahasim me panairin e vitit të shkuar, këtë vit ka rritje jo vetëm të numrit të ekspozuesve, por edhe të prodhimeve dhe shërbimeve që ofrojnë sektorët në fjalë. Në këto dy panaire, po marrim pjesë komani jo vetëm nga vendi dhe rajoni, por edhe nga e gjithë bota. Në këtë panair në mesin e shumë kompanive ekspozuese ishte edhe kompania farmaceutike amerikane CTK Biotech. Inc. Dan Hanlon, menaxher, i cili tha se kanë ardhur për herë të parë në Kosovë dhe shpresojnë se do të gjejnë përfaqësues për Kosovë. Ndërsa, Dieter Macher, nga kompania Macher Solutions e Gjermanisë tha se kompania e tij ofron këshilla, shërbime dhe softuer rreth biznes inteligjencës. Miray Portokaldali, zyrtare e kompanisë higjienike të palomave IDA nga Turqia, tha se po marrin pjesë në panair me qëllim të zgjerimit të tregut. Panairi është i hapur deri më 29 maj në Pallatin e Rinisë në Prishtinë. ■ B. Toska

Hapet Panairi i Teknologjisë

PRISHTINË 27 MAJ - Nën patronatin e Ministrisë së Transportit dhe Postë-Telekomunikacionit (MTPT), të enjten është hapur edicioni i shtatë i Panairit të Teknologjisë Informative, "ITTF2010".
Drejtori i Departamentit të Teknologjisë Informative në MTPT, Agim Kukaj, ka deklaruar se MTPT-ja është angazhuar në disa projekte së bashku me programe të cilat sponsorohen nga USAID-i dhe Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian.
"Kjo ministri po punon dhe po përpiqet që të krijojë ambient për zhvillimin e teknologjive të reja dhe që të krijojmë kushte për zhvillimin e teknologjisë informative dhe shërbimeve telekomunikuese", ka thënë ai.
Edhe Alban Kastrati nga kompania telekomunikuese IPKO ka thënë se IPKO njihet si një kompani moderne me shërbime të avancuara dhe ka një reputacion të një kompanie që kujdeset për të gjithë konsumatorët e saj.
"Me pjesëmarrjen e saj në këtë panair, ajo synon të jetë sa më afër konsumatorëve të saj me të gjitha produktet dhe shërbimet të cilat i ofron kompania dhe të jetë përfaqësuesja më e mirë e komunitetit të biznesit", ka deklaruar ai.
Panairi do të qëndrojë i hapur deri më 29 maj. Në të do të ekspozohen edhe produkte nga teknologjia, ku do të ketë më shumë pajisje, më shumë softuerë, programe trajnuese, programe dhe zgjidhje nga 'business intelligence'. (Afet Bela)

U hap panairi i Teknologjisë Informative

Prishtinë, 27 maj - Përfaqësues të fushës së Teknologjisë Informative dhe Telekomunikacionit nga Kosova dhe më gjerë kanë ekspozuar në edicionin e shtatë të panairit të Teknologjisë Informative "ITTF 2010", i cili u hap të enjten në Prishtinë, ndërkaq do të qëndrojë i hapur deri më 29 maj. Ky panair organizohet nën patronatin e

Ministrisë së Transportit dhe Postë-Telekomunikacionit (MTPT) dhe sipas organizatorëve, ky edicion shënon rritje jo vetëm të numrit të ekspozuesve, por edhe të produkteve dhe shërbimeve që ofron sektori në fjalë, ku do të ketë më shumë pajisje, më shumë softuerë, programe trajnuese, programe dhe zgjidhje nga "business intelligence". Drejtori i Departamentit të Teknologjisë Informative në MTPT, Agim Kukaj, tha se kjo ministri po punon dhe po përpiqet të krijojë ambient për zhvillimin e teknologjive të reja. "Jemi të angazhuar në disa projekte së bashku me programe, të cilat sponsorohen nga USAID-i. Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian për Edukim që të krijojmë kushte për zhvillimin e Teknologjisë Informative dhe Shërbimeve Telekomunikuese", tha ai. *(a. m.)*

Prezantohet teknologjia e re informative

PRISHTINË. Kompani të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare të teknologjisë informative, telekomunikacionit, mjekësisë dhe farmaceutikës janë mbledhur edhe një herë në Prishtinë për të ekspozuar prodhimet dhe shërbimet e tyre në edicionin e shtatë të panairit ndërkombëtar të teknologjisë informative dhe telekomunikacionit "ITTF" dhe edicionin e gjashtë të mjekësisë dhe farmaceutikës "Medikos", të organizuar nga kompania CEO, nën mbikëqyrjen e Ministrisë së Transportit dhe Postë Telekomunikacionit dhe në bashkëpunim me shoqatën për teknologji informative STIKK.

Sipas Lulëzim Krasniqit, menaxher i CEO-së, në krahasim me panairin e vitit të shkuar, këtë vit ka rritje jo vetëm të numrit të ekspozuesve, por edhe të prodhimeve dhe shërbimeve.

Ndërkaq, Agim Kukaj, drejtor i Departamentit të Teknologjisë Informative, duke folur për angazhimin e MTPT-së, tha se në vazhdimësi po bëhen përpjekje për të krijuar mjedis mundësues për zhvillimin e teknologjive të reja. "Ky panair është ngjarje me rëndësi për sektorin e teknologjisë informative dhe komunikuese, si dhe për zhvillimin e shoqërisë informacionit", tha Kukaj. **A. UKA**

ME TË REJAT NGA FUSHA E TEKNOLOGJISË DHE MJEKËSISË

U hap panairi i teknologjisë informative dhe i mjekësisë farmaceutike

Milikije Beqiri

Prishtinë

Për të shtatën herë me radhë, në vendin tonë është hapur panairi i Teknologjisë informative, "TTTF2010", dhe Panairi i mjekësisë farmaceutike "MEDIKOS", të cilët paraqesin një platformë që pasqyrojnë stadin e zhvillimit të sektorëve të veçantë industrial. Në këto panaire, shumë kompani i paraqitën produktet e tyre më të reja, nga teknologjia informative dhe ajo e mjekësisë. Firmat që kishin ardhur për të prezantuar produktet e tyre në këtë panair, u shprehën optimist se interesimi i qytetarëve për tu njohur me më të rejat nga teknologjia informative nuk do të mungojë. Organizatorët e panairit u shprehën se, rëndësia e këtij panairi është mjaft e madhe për ekonominë dhe industrinë e Kosovës. Drejtori i Departamentit të teknologjisë informative, në Ministrinë e Transportit dhe Postë-Telekomunikacionit, Agim Kukaj, tha që MTPT-ja, vazhdimisht është duke bërë përpjekje që të krijojë një ambient për zhvillimin e teknologjive të reja. "Ministria e Transportit dhe Postë-Telekomunikacionit, po punon dhe po përpiqet që të krijojë ambient mundësues për zhvillimin e teknologjive të reja. Jemi të angazhuar në disa projekte së bashku me programe të cilat sponsorohen nga USAID-i, dhe zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian për edukim, që të krijojmë kushte për zhvillimin e teknologjisë informative dhe shërbimeve telekomunikuese", ka thënë Kukaj. Ai më tutje ka shtuar se me qëllim të krijimit të bazës ligjore, dhe administrative të kodit shtetërorë të internetit MTPT-ja, së bashku me autoritetin rregullativ të telekomunikacionit janë duke punuar në marrjen e domenit, si dhe deri në fund të vitit do të krijohet nyja e shkëmbimit të internetit. "Në aspektin legjislativ jemi duke punuar në ligjin për komunikimin dhe elektronikë, i cili do të thjeshtësoj regjimin licencues në Kosovë", ka thënë Kukaj. Drejtoresha ekzekutive e Shoqatës së Teknologjisë së Informacionit, Vjollca Çavolli theksoi se STIKK-u, ka për synim të bashkërendojë aktivitetin dhe interesat e kompanive në lëmin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit. "Duke e marrë teknologjinë e informacionit dhe të komunikimit si një sigurim të ri të zhvillimit ekonomik, dhe të gjenerimit të vendeve të reja të punës çdo aktivitet promovimi dhe njoftimi për sektorin, dhe për kompanitë anëtarë të shoqatës është e mirëseardhur" është shprehur Çavolli. Ndërsa, Lulzim Krasniqi, zyrtarë për informim nga CEO-së, tha që ky panair ka një rëndësi të veçantë për ekonominë dhe industrinë e Kosovës. "Panairi si i tillë paraqet një platformë që pasqyron situatën e zhvillimit të sektorëve të veçantë industrial. Kosova si vend i cili aktualisht shquhet më shkallë të lartë të importit në një të ardhmen shumë të afërt, mund të shquhet për eksport pikërisht në produktet sektorit të IT-së", ka thënë Krasniqi. Ndërsa firmat që prezantonin produktet e tyre në këtë panair, u shprehën se optimist që gjatë këtyre ditëve qytetarët e Kosovës, do të njoftohen më shumë me produktet që ata i kanë prezantuar. Në këtë panair morën pjesë edhe dy kompanitë më të mëdha të telekomunikimit në Kosovës, VALA dhe IPKO. Zyrtarja e marketingut Leonora Nikçi, tha që Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës ka në vete shumë produkte në treg, por kanë prezantuar vetëm disa prej tyre. "Ne i prezantojmë vetëm disa produktet e shërbimet e PTK-së, që marrim pjesë me internet WI FI (Vairles), që është falas për të gjithë pjesëmarrësit e këtij panairi, dhe është mundësia e testimit të shpejtësisë të internetit. Po ashtu, kemi hapë një mini pikë shitëse për mbushjet elektronike dhe shitjen e SIM kartela dhe të gjitha produkteve që i posedon PTK-ja. Zyrtari për marrëdhënie me publikun, Alban Kastrati, ka thënë që kompania e IPKO-së ka të lanësuar katër shërbime të telekomunikacionit dhe të biznesit. "Këto produkte të cilat i ofrojmë ne, janë të përkushtuar që të jem sa më afër konsumatorëve, qofshin ata individual ose të bizneseve. Në pjesëmarrjen tonë synojmë që ti promovojmë produkte tona të biznesit, që jemi më shumë të fokusuar në pako të biznesit. Ne jemi të përqendruar që të promovojmë produkte të biznesit përkatësisht pako më atraktive që kanë të bëjnë me biznesin dhe më të kërkuara nga konsumatorët", ka theksuar Kastrati. Disa përfaqësues të bizneseve janë ankuar për doganë dhe tatim të lartë që ka Kosova si shtet i ri. Përfaqësues i firmës CANON, për Kosovë Burim Hoxha tha se, qëllimi i tyre është ti njoftojmë qytetarët e Kosovës me teknologjinë më të re që ka lanësuar në treg Canon. "Vështirësia e jonë që disa vite është me tatime dhe dogana që janë më të shtrenjta në krahasim me rajonin. Për shkak të doganës dhe tatimit të shtrenjtë, produktet e firmës Canon, janë më të shtrenjtat në Kosovë", tha Hoxha. Në vizitë të këtij panairi ishte edhe William Voker, i cili tha se është një dallim shumë i madh në ekonominë e Kosovës, krahasuar me vitet e kaluara. Voker shtoi se, Kosova ka mundur të arrijë edhe më shumë se që ka arritur. Po ashtu edhe panairi në sektorin e mjekësisë dhe farmaceutikës "Medikos", ka arritur të mbledh faktorët relevantë, të cilët merren me fushën e mjekësisë, stomatologjisë dhe pajisjeve të ndryshme mjekësore.

Edicioni i shtatë me radhë i Panairit të Teknologjisë Informative dhe Telekomunikacionit-ITTF, gjatë ditës së djeshme (27 maj) është hapur zyrtarisht për vizitorë. Për dallim prej vitit të kaluar, këtë vit numri i kompanive pjesëmarrëse është rritur dukshëm

ITTF hap dyert për vizitorë

Çelik Nimani
27 maj, Prishtinë

Me një ceremoni solemne të organizuar nga CEO, e cila u përkujdes edhe për organizimin e ITTF, është bërë hapja zyrtare e këtij panairi. Të pranishëm ishin përfaqësues të institucioneve vendore si dhe të kompanive të ndryshme që i përkasin sektorit të Teknologjisë Informative.ITTF këtë vit u duk shumë më serioz në krahasim me vitin e kaluar, dhe këtë e tregon më së miri edhe numri më i madh i kompanive vendore e ndërkombëtare, si dhe serioziteti i tyre në prezantimin e produkteve harduerike, softuerike, prezantimin e shërbimeve, etj.

Panairi po mbahet nën patronatin e Ministrisë së Transportit dhe Telekomunikacionit, organizimin e CEO dhe mbështetjen e shoqatës STIKK. Ai do të zgjasë deri më 29 maj, ndërsa paralelisht me ekspozuesit do të ketë edhe ligjërata nga përfaqësues të kompanive ndërkombëtare.

"ITTF 2010 "mbyllet sot

PRISHTINË. Edicioni i shtatë i panairit të teknologjisë informative, ITTF 2010" në Pallatin e Rinisë dhe Sporteve është i hapur vetëm edhe sot. Ky panair ka mbledhur së bashku dasharirët kryesorë të fushës së teknologjisë informative dhe telekomunikacionit nga Kosova dhe më gjerë.

Sipas organizatorëve, edicioni i sivjetmë i panairit ka shënuar rritje jo vetëm të numrit të ekspozuesve, por edhe të produkteve dhe shërbimeve që ofron ky sektor. Sivjet ofrohen më shumë pajisje, softuerë, programe trajnuese etj. Panairi është organizuar nga Congres and Event Organisation (CEO), nën përkujdesjen e Ministrisë së Transportit dhe Postë-Telekomunikacionit dhe me mbështetjen e STIKK-ut. **L.C.**

Mbyllet panairi

Eshtë mbyllur panairi ndërkombëtar i teknologjisë informative dhe telekomunikacionit "ITTF" edicioni i shtatë dhe ai mjekësisë dhe farmaceutikës "Medikos" edicioni i gjashtë, të cilët janë organizuar nga CEO. Për tre ditë(27-29maj) në këto panaire ekspozuan kompani të mëdha nga Kosova, rajoni dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës të arriturat më të reja nga fusha e mjekësisë dhe teknologjisë informative. Ngjarja u karakterizua edhe me aktivitete të shumta, takime të bizneseve si dhe u bë shtrirja apo zgjerimi i këtyre kompanive edhe në territorin e Kosovës. Kompania farmaceutike amerikane CTK Biotech. Inc ka sjellur prodhimet e tyre për herë të parë në tregun e Kosovës. Menaxheri i kësaj kompanie Dan Hanlon, e vlerëson panairin si shumë të dobishëm, duke shpresuar se do të shtrijnë tregun e shitjes edhe në Kosovë. Po ashtu për herë të parë në panair ishte edhe kompania turke e prodhimeve higjenike e palomave IDA. Miray Portokaldali, zyrtare e kësaj kompanie, tha se janë për herë të parë në panair dhe se janë shumë të kënaqur me numrin e vizitorëve dhe bizneseve të interesuara që të jenë përfaqësues të tyre. ■ **Besim Toska**

June 2010, Prishtina

CEO-Congress & Event Organization